

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Politologu i njohur kritikon reagimin e Ramës dhe Demos pas propozimit për ministër: Emërimi kalon nga Presidenti dhe Kuvendi
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/politologu-i-njohur-kritikon-reagimin-e-ervin-demos-pas-pro-pozimit-per--i400961
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 10:09:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 10:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	de12765fea4df57edba4c1f6458cbc33ed394cdda058ec07ecb759fe0d4bac17
TEKSTI	c56dc0afa14f7705600716624857733d6faefcd70a813f80f54fe7dbf2de7fa1
PAMJA	16dc78b9518a133cd7276ae4e4e6b309f223951bf09f8fd0647afe75f907f482

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4803d019e4c364e88ad704f82476e225b5d568b7ea522675692e97320af1e635
E MËPARSHMJA	7b93deae92ba826ce06d31ed6b5b0ec233816c0e51b5b8d6377bc71bf880cd72
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4803d019e4c364e88ad704f82476e225b5d568b7ea522675692e97320af1e635>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



12 numrat e parë FALAS!

[Version PDF](#)

[Abonohu te Revista](#)



- [Kreu](#)
- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)
- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)



Created and monetized by  mediadesk



Çështjet kryesore

Live Updates

[Arrestohet Ergys Agasi](#)

E Enjte 10:25

Live Updates

["Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!](#)

E Hënë 09:32

Live Updates

[SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjijkës](#)

E Martë 14:24

[Politikë](#) 11 Shtator 2026, 12:00

Politologu i njohur kritikon reagimin e Ramës dhe Demos pas propozimit për ministër: Emërimi kalon nga Presidenti dhe Kuvendi

Shkruar nga Newsbomb



 Politologu i njohur kritikon reagimin e Ramës dhe Demos pas propozimit
Momenti kur Rama prezanton ndryshimet në qeveri

Ndryshimet e fundit në kabinetin qeveritar të kryeministrit Edi Rama kanë sjellë reagime edhe në radhët e opinionit publik. Politologu Afrim Krasniqi ka kritikuar mënyrën se si u komunikua nga kryeministri Edi Rama propozimi i Ervin Demos për postin e ministrit të Brendshëm, duke vënë theksin te procedura kushtetuese që duhet të ndiqet për emërimin e një ministri.

Kritika e Krasniqit vjen pasi Demo falënderoi kryeministrin Edi Rama për besimin e dhënë, menjëherë pas njoftimit për propozimin e tij në krye të Ministrisë së Brendshme, duke shkarkuar Besfort Lamallarin.

Sipas Krasniqit, propozimi i kryeministrit është vetëm një nga hallkat e procesit institucional dhe nuk e bën automatikisht një person ministër. Ai sjell në vëmendje procedurën e përcaktuar nga Kushtetuta, që përfshin dekretimin nga Presidenti i Republikës dhe shqyrtimin në Kuvend.

Në një reagim të gjatë në Facebook, politologu e përdor rastin për të ngritur një debat më të gjerë mbi funksionimin e institucioneve dhe raportin mes partisë, qeverisë dhe shtetit.

“Nga premtimi ‘ne bëjmë shtet’ te akti ‘shteti jam unë’”, e titullon Krasniqi reagimin e tij.

Ai rikujton sloganin “Ne bëjmë shtet”, të përdorur në të kaluarën nga socialistët, duke argumentuar se sot, sipas tij, vendimmarrja politike është përqendruar gjithnjë e më shumë te lideri i partisë.

Reagimi i plotë i Krasniqit:

Nga premtimi “ne bëjmë shtet” te akti “shteti jam unë”

“Ne bëjmë shtet”, - ishte slogani kryesor në fjalimet me militantët votues. Funksionoi, natyrisht jo për shkak të sloganit, besimit dhe as për shkak se qytetarët votues e besuan ose e kërkuan këtë. Funksionoi më shumë për imazh publik, sidomos në kushtet kur Shqipëria kritikohet për nivel kritik të funksionalitetit të shtetit të së drejtës, korrupsion, personalizim pushteti dhe zhdukje të kufirit midis partisë e shtetit.

Pastaj Partia u mbledh në një hotel dhe u bë emërimi i ministrave. Njëri prej tyre mbeti i habitur kur u emërua, dhe kishte të drejtë. Nuk e dinte, nuk e meritonte, nuk e bënte dot. Pastaj të njëjtin e ndryshuan brenda pak muajsh dhe e çuan në ministri tjetër. Dështoi me sukses dhe siç ndodh me ministrat e shkarkuar, pas funksionit merren në punë në kryeministri, “pranë shefit”, një emërim garancie dhe imuniteti.

Pastaj shohim në mediat sociale se kryeministri ka shkarkuar ministrin e brendshëm, ka emëruar tjetrin dhe ka bashkuar dy ministri (d.m.th., duhen tre së paku dekrete shkarkim ministri (2) dhe bashkim/krijim ministrie e re me ministër të ri). Shqipëria ka një Kushtetutë, e cila përcakton se ministri quhet i tillë jo kur propozohet (jo emërohet) nga kryeministri ose partia, por kur dekretohet nga Presidenti, votohet në parlament dhe më pas betohet përpara Presidentit. Është proces, jo akt shokësh në facebook. Më 2004 parlamenti refuzoi disa dekrete ministrash të propozuar nga kryeministri, ndonëse ishin deputetët e së njëjtës parti. Por kishte parti, sot ka individ-lider që mbështetet në mënyrë të verbër nga një strukturë që zyrtarisht quhet parti. Nuk ka debat, zgjedhje, konkurrim.

Ja ku jemi: nga premtimi “ne bëjmë shtet” kalohet te akti “shteti jam unë”. Nuk ka rëndësi Kushtetuta, nuk ka rëndësi procesi institucional, nuk ka rëndësi votimi në parlament, as dekretimi, as betimi, Partia të emëron, partia të shkarkon dhe kur themi partia nënkuptojmë shefin e saj. Dhe për ta plotësuar kuadrin, i shkarkuari (sipas Kushtetutës është ende ministër) është i kënaqur dhe mer emërimin e ri në kryeministri, i propozuari (i pa dekretuar, i pa votuar, i pa betuar) flet si ministër i ri në detyrë. Pa folur më pas për strukturën, pse duhet të kishim ministër shteti më 2025 kur e shkrin më 2026? Krijim ministrie për një person? Kur personi ndryshon post, shkrihen ministratë për të? etj, etj.

Shqipëria ka pasur dhe ka politikanë, parti, qeveri, ministra, zyrtarë të korruptuar, abuzive, etj, etj, por Shqipëria ka pasur dhe ka nevojë për shtetarë, për modele pozitive drejtimi, për respekt të Kushtetutës, ligjeve dhe integritetit në përfaqësim. Këto mungojnë ende dhe në fakt, vetëm këto mund të jetësonin premtimin e (ri)shkelur “ne bëjmë shtet”.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu

Politikë

["Më vjen ndot", ministria Erjona Ismaili e sfidoi për të ardhur në Shqipëri, Arben Ahmetaj e injoron nga arratia: Kush është kjo? E njihni ju, se unë jo \(REAGIMI\)](#)

E Premte 13:10

Politikë

[Nga sot pjesë e stafit në Kryeministri, Besfort Lamallari reagon pas lirimit si ministër: Ka qenë nder për mua, tani do t’ia kthej Ramës besimin që pati](#)

E Premte 13:03

Politikë

[Rama e bëri sot ministër të Brendshëm, Gazment Bardhi zbulon lidhjen e Ervin Demos me kreun e SPAK: Braho të distancohet](#)

E Premte 12:35

Politikë

[“Prania Besnike” e socialistëve vihet në praktikë duke filluar nga SOT, do të marrin pjesë edhe ministrat](#)

E Premte 11:57

Politikë

[Sali Berisha sfidon Altin Dumanin dhe SPAK-un nga Amerika, takon Prokurorin e Përgjithshëm të SHBA-së](#)

E Premte 11:32

Politikë

[Rama u shfaq në Pogradec me “Benz”-in mbi 100 mijë euro, ministria: E paguajmë me lekët e buxhetit të PS-së! E nevojshme për sigurinë e kryeministrit](#)

E Premte 11:25

Politikë

[Karakaçi zbulon tri projektet 110 milionë euroshe për energjinë elektrike, përgjigjet dhe për zhvendosjen e mbikalimeve në autostradë](#)

E Premte 11:23 Newsbomb

Politikë

[Audiopërgjimi dhe akuzat e Ahmetajt, reagon ministria e Ramës: Kam ndot, je i zhytur në llumin tënd! Po ke guxim hajde përballu me drejtësinë](#)

E Premte 11:07

Politikë

[U kallëzua nga ish-ortaku se fshehu dhe pastroi 1.5 milionë euro, deputeti demokrat Luan Baçi merret nën hetim nga SPAK](#)

E Premte 10:53

Politikë

[Ministria tregon zonat ku janë apartamentet 60 mijë euro për të rinjtë: Pastaj le ta shesin, të blejnë një më të madh](#)

E Premte 10:46

Politikë

[Ambasada e SHBA-së në Tiranë përkujton 25-vjetorin e 11 Shtatorit: Nderim për viktimat dhe heronjtë](#)

E Premte 09:59

Politikë

[U vendos në krye të Ministrisë së Brendshme, Ervin Demo falenderon Ramën për besimin: Do vazhdoj të çoj përpara punën e nisur nga Besforti](#)

E Premte 10:33

Politikë

[Edi Rama merr me vete në Kryeministri Besfort Lamallarin: Faleminderit për shërbimin si ministër i Brendshëm](#)

E Premte 10:25

Politikë

[Klodiana Spahiu zyrtarisht ministre e Shëndetësisë, BETOHET para Bajram Begajt](#)

E Premte 10:15

Politikë

[Edi Rama shkarkoi Besfort Lamallarin, vendos t'ia besojë ministrinë e Brendshme Ervin Demos \(PROFILI\)](#)

E Premte 10:10

Politikë

[Një çerek shekulli nga 11 shtatori, Begaj përkujton sulmet terroriste në SHBA: Nderojmë kujtimin e 2977 viktimave të pafajshme](#)

E Premte 09:21

Revista



Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit

Aktualitet

[46 mjete të reja për operimet në pistë, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës investon 2 milionë euro](#)

E Premte 13:36

Sporti

[Ish-zv.ministri thumbon futbollistin Myrto Uzuni: Kam shumë merak, ti në emër të kujt e bleve hotelin në Palasë?!](#)

E Premte 13:28

[Zbulo më shumë artikuj >](#)

Hapësire reklamuese

bombvideo

[Shiko video të tjera në Newsbomb Youtube](#)



[Blutë e Vlorës prangosin dy “skifterët” që vodhën 3 makina, 40 vjeçari grabiti Benz-in deri...](#)



[Më i "lumtur se kurrë, Berisha merr pjesë në Konventën e Republikanëve të Trump](#)



[18 vjeçari "nuk zë mend", Policia i tregon vendin: Ishte në arrest shtëpie për vjedhje, doli dhe...](#)



["Të ecim me tjetër ritëm", Taulant Balla kërkon bashkëpunim me opozitën për Shqipërinë në BE](#)



[Intervista e Arben Ahmetajt, Bardhi thumbon keq socialistët: Ia jepni vetë informacionet](#)



[Aksident në autostradën Levan-Tepelenë, makinat përplasen "kokë më kokë"](#)

**op
ed**

OpEd

[Ramë Pagëzimori, Rilindishtja dhe arti i qeverisjes me fjalor](#)

E Diel 16:22 A. J. M. M. M.

OpEd

[Një moment vendimtar për Shqipërinë](#)

E Martë 13:45

OpEd

[Një dritare mundësie për Tiranën: Pse “Jo”-ja e Islandës ndaj BE-së favorizon integrimin e Shqipërisë](#)

E Diel 18:33



-
-
-
-

Newsbomb është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

Drejtori i Përgjithshëm: Retin Toka
NIPT: L42417011Q

[Abonohu te Revista](#)

Created and monetized by  mediadesk

- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)

- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Teknologji](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)

Merr lajme me email

[ME REGJISTRO](#)

- [Kontakt](#)
- [Të drejtat e përdorimit](#)
- [Cookies](#)

Created and monetized by  mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.